



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 489/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lidhjes Demokratike (LDK) dega në Drenas, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Drenas, për shkak të vendosjes së banerit në objektet publike, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Drenas, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Drenas, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2100 (dymijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi

Arsyetim

PZAP-i, më datë 04.11.2013 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik LDK dega në Drenas, në të cilën theksohet se me datën 03 nëntor 2013, në ora 12:15 aktivistet e Lidhjes Demokratike të Kosovës dega në Drenas kanë vërejtur një flamur të PDK-së që ishte ngjitur në objekt publik konkretisht në shkollën e mesme Fehmi Lladrovci në Drenas. Duke qenë se, shkollat janë pronë publike, ngjitja e banerave të partive politike është në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotot nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se si flamuri i PDK-së gjatë ditës së zgjedhjeve gjendet dhe është i vendosur brenda rrethojave të shkollës veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik PDK është përgjegjës për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LZP-së, që ndalohet shpërndarja ose

shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës të çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit ose bërja e fushatës në çfarëdo mënyre dhe meqenëse flamuri i subjektit politik PDK-së është i vendosur brenda rrethojave të shkollës, veprime këto të cilat e cilat e bëjnë përgjegjëse dhe kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 36.1 pika a) dhe nenit 120 paragrafi 1 pika c), lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 489/2013 më datën 06.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*